



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 12.4 të Ligjit Nr.03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në zbatim të nenit 21, paragrafi 4, të Rregullores Nr. 01/2018 për Marrëdhënie Pune, Zyra Kombëtare e Auditimit, me datën 05.05.2020, publikon këtë:

SHPALLJE

për Angazhim në Punë dhe Detyra Specifike – dizajn grafik

I. Angazhim për shërbime: Një (1) Ekspert për punimin e dizajneve grafike/infografika për raportet e auditimit të hartuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Numri i referencës: EDG/ZKA/10-05/20

Shërbimet dhe detyrat profesionale:

- Përgatit të gjitha projektet e dizajnit, që nga konceptimi deri te shpërndarja;
- Përcakton imazhet, fontet dhe formatet duke përdorur softuerin e dizajnit grafik;
- Hulumton ide për të paraqitur koncepte dhe për të reklamuar produktet / shërbimet në rrjetet sociale, webfaqe, televizione, gazeta etj;
- Përdor teknikat e tipografisë;
- Krijon versione të ndryshme të dizajneve, logove, koncepte për broshura, prezantime, flyer-a, fletpalosje etj ;
- Asiston me realizimin dhe përgaditjen e videove dhe fotografive;
- Është i/e interesuar të mësojë dhe të përshtatet në ekipin e kompanisë.

Përgjegjësitë:

Eksperti i angazhuar për kryerjen e detyrave, do të punoj me zyrtarët përgjegjës të njësive organizative për punë audituese dhe dizajni grafik/infografika për secilin raport finalizohet në koordinim të përbashkët ndërmjet tyre.

Varësisht prej nevojave për kryerjen e punëve dhe numrit të raporteve të auditimit, eksperti i angazhuar duhet të punoj nën presion kohor dhe duke i respektuar kërkesat dhe afatet e parashtruara nga zyrtarët përgjegjës.

Mënyra dhe periudha e angazhimit për shërbime në punë dhe detyra specifike është gjashtë (6) muaj. Pagesa bëhet në bazë mujore në nivelin ZKA/07.

Kushtet themelore për angazhimin në punë dhe detyra specifike:

- Përgatitja profesionale universitare – diplomë fakulteti në fushën e dizajnit grafik;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në dizajnin grafik/infografikë dhe prezantime të ngjajshme.

Aftësitë tjera:

- Njohuri të shkëlqyera të programeve kompjuterike Adobe Package (Adobe Photoshop, Adobe Illustrator, Adobe Indesign, Corel Draw, Adobe Acrobat Pro, etj)
- Aftësi për të realizuar dhe komunikuar qartë konceptet dhe idetë e dizajnit;
- Shkathtësi të mira komunikuese;
- Të mendojë në mënyrë kreative për të nxjerrë ide dhe koncepte të reja;
- Të jetë kreativ dhe inovativ;

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga uebfaqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210- Prishtinë apo të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: rekrutimi@oagks.org.

Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur:

- dëshmitë për kualifikimin shkollor,
- dëshmitë për përvojën e punës, dëshmitë për kualifikimet tjera nëse ka dhe së paku dy referenca për punët e deritanishme të kryera;
- kopjen e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i pakompletuar me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohet.

Shpallja është e hapur pesë (5) ditë, nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në gazetën elektronike “Koha Ditore” me datën 05.05.2020 dhe mbetet e hapur deri më datën 10.05.2020. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext: 1025